

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 349/14

31 gusht 2015

Mendim mospajtues i gjyqtarit të EULEX-it Piotr Bojarczuk i bashkangjitur në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të datës 31 gusht 2015, sipas nenit 398 par.4 të KPP-së

Si kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues i kësaj lënde, unë nuk pajtohem me vendimin e shumicës lidhur me dy aspekte: (1) shkeljes esenciale të nenit 384 par. 1 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së dhe (2) shkeljes esenciale të nenit 384 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 8 të KPP-së. Unë konsideroj se këto çështje të mospajtit janë mjaftueshëm të rëndësishme për ta justifikuar mendimin tim mospajtues me shkrim.

Shkelja e nenit 384 par. 1 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së

Me shumicë është vendosur se aktgjykimi përmban shkelje esenciale të nenit 384 par. 1, pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 6 dhe 7 të KPP-së për shkak të faktit se dispozitivi është i pakuptueshëm, i paqartë dhe kundërthënëse me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga gjykata e shkallës së parë. Kolegji thekson se është e paqartë se cilat fakte dhe veprime janë vërtetuar me cilat prova nga Gjykata Themelore sepse nuk ka asnjë përshkrim faktik i cili do të mund t'i qartësonte veprimet e caktuara inkriminuese të të akuzuarit.

Në kundërshtim me aktgjykimin, unë konsideroj se është mjaft e qartë se cilat fakte dhe veprime kanë qenë të vërtetuara nga Gjykata Themelore. Gjykata Themelore në mënyrë të qartë i ka paraqitur arsyet për secilën pikë të aktgjykimit. Për më tepër gjykata në mënyrë të suksesshme ka sjellë arsyetim të duhur rreth saktësisë së provave si edhe arsyeve mbështetëse për të cilat gjykata i ka miratuar propozimet konkrete të palëve. Unë nuk po shoh mungesë të arsyetimit në vërtetimin e ekzistimit të veprës penale si edhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Në kundërshtim me gjetjet, unë besoj se më tej është mjaft e qartë nga aktgjykimi i shkallës së parë kush ka përfituar nga veprimet dhe kush është pala e dëmtuar. Për pikën 1 është M.K., M.Q. dhe J.A. të cilët kanë siguruar dobinë pasurore në vlerën prej 30.050,- EUR, për pikën 2 është QE Gulistan e cila ka përfituar 20.120,- EUR për shkak të lirimit nga qiraja dhe për pikën 3, gjykata e shkallës së parë ka pohuar se fabrika ‘Kamila’ ka pasur dobi pasurore në vlerën prej 4.500,- EUR në formë të shfrytëzimit pa pagesë të pronës së komunës. Lidhur me pikën 4, veprimet e të pandehurve kanë pasur qëllim për t’i shkaktuar dëm personit tjetër, në veçanti, në funksionimin e drejtësisë. Me ndalimin e ekspertëve, të pandehurit kanë shkaktuar vonesa në zhvillimin e suksesshëm të lëndës civile pronësore. Pala e dëmtuar është interesi publik në funksionimin e duhur të drejtësisë. Për të gjitha pikat, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të përshtatshme e ka urdhëruar një ekspert për të bërë një analizë të thellë dhe ka bërë po ashtu një vlerësim të plotë.

Së fundi, kolegji konsideron se nuk ka qartësim të mjaftueshëm rreth asaj se cili i pandehur cilin përfitim ka pasur. Duke vepruar në këtë mënyrë, sipas këndvështrimit tim, kolegji nuk e zbaton drejt ligjin. Sipas nenit 422 par. 1 të Kodit Penal, ligji kërkon “vetëm” qëllim të caktuar me të cilin synohet dobia pasurore e përvetësuar; ligji nuk kërkon që dikush *de facto* të marr një përfitim të caktuar. Nga aktgjykimi i shkallës së parë është e qartë, e shtjelluar mirë dhe e provuar se të pandehurit kanë vepruar me qëllim të caktuar sikurse kërkohet për ta kryer veprën penale të *keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar* në përputhje me nenin 422 të Kodit Penal.

Shkelja e nenit 384 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 8 të KPP-së

Vendimi i Gjykatës së Apelit më tej është i bazuar në shkelje esenciale të nenit 384 pikës 1.12 lidhur me nenin 370 par. 8 të KPP-së. Kolegji pohon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e të pandehurve kur ka përcaktuar dënimin. Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit është e paqartë se si gjykata e shkallës së parë e ka justifikuar dënimin dhe cilat rrethana lehtësuese dhe rënduese ekzistojnë dhe duhet të merren parasysh kur bëhet individualizimi i dënimit. Kolegji thekson se gjykata e shkallës së parë është e lirë në vendimin e saj kur vlerëson provat ndërsa Gjykata e Apelit duhet t’i rivlerësojë vetëm po që se gjen gabime ligjore në vlerësimin e bërë nga gjykata e shkallës së parë. Më tutje, në hapin e radhës, i merr

parasysh gabimet ligjore duke e bërë të domosdoshëme prishjen e aktgjykimit. Megjithatë unë konsideroj se gjykata e shkallës së parë ka bërë një vlerësim të drejtë kur ka përcaktuar dënimin. Ajo i ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Llogaritja e dënimit ndaj të pandehurve është përshkruar në mënyrë të qartë, të plotë dhe të tërësishme në faqet 52-55 të aktgjykimit.

Lidhur me të pandehurin **M.**, pozita e tij e lartë është konsideruar, në veçanti, rrethanë rënduese. Për këtë arsye, barra më e madhe i bie pikërisht atij. I pandehuri **P.** ka vepruar në cilësinë e drejtorit të drejtorisë komunale të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor. Për këtë, ka qenë detyrë e tij ligjore që të jetë në dijeni rreth procedurave për ndarjen e tokës publike; ai është dashur të bëjë përpjekjet e duhura për zbatimin e procedurës së përcaktuar me ligj. Sa i përket të pandehurit **A.**, trupi gjykues e ka konsideruar si rrethanë lehtësuese faktin që ai vetëm e ka ekzekutuar vendimin tashmë të marrë nga kryetari i komunës. Sa i përket të pandehurit **U.**, Gjykata Themelore ka konsideruar moshën e të pandehurit dhe gjendjen e tij shëndetësore – nevojën për ta kryer dy herë në javë dializën, si një rrethanë lehtësuese. Lidhur me të pandehurin **T.**, trupi gjykues ka vendosur që t'i shqiptojë dënim të lehtë duke e pasur parasysh rrethanën lehtësuese se i njëjti ka qenë aktiv për arritjen e marrëveshjes dhe se ai e kishte vizituar gjykatën dhe kryetarin e gjykatës për të gjetur një zgjidhje. Lidhur me të pandehurin **K.**, gjykata e shkallës së parë është e mendimit se i pandehuri në cilësinë e drejtorit të drejtorisë komunale të zyrës administrative për çështje juridike pronësore, ka qenë në dijeni se ndarja e truallit në fjalë fabrikës së çokollatës ka qenë e kundërligjshme, mirëpo përkundër kësaj e kishte udhëzuar të pandehurin **A.** që ta bartte pronësinë e tokës në fjalë para se ta merrte pëlqimin e kuvendit komunal. Lidhur me pikën 4, është e qartë për trupin gjykues se i pandehuri **K.** e ka shfrytëzuar pozitën dhe cilësinë duke qenë i pakujdesshëm për punën e gjykatës dhe me këtë duke e penguar zhvillimin e procedurës. Në këtë pikë, konstatoj se gjykata themelore e ka lidhur gabimisht të pandehurin **K.** me ndarjen e tokës fabrikës së çokollatës (pika 3), kur e ka bërë llogaritjen e dënimit. I pandehuri **K.** nuk ka qenë i përfshirë në ndarjen e truallit fabrikës së çokollatës (pika 3) por në ndarjen e truallit Qendrës Edukative Gulistan (pika 2). Megjithatë, konstatoj se lidhja e gabuar në fjalë e kësaj pike është vetëm një “gabim shtypi”, i cili nuk ka ndikim në ligjshmërinë e llogaritjes së dënimit. Gabimi në fjalë nuk është përmbajtjesor.

Në fakt, unë shpreh fuqishëm mospajtimin me vendimin e Gjykatës së Apelit se nuk është bërë vlerësimi gjatë llogaritjes së dënimit. Për mendimin tim, Gjykata e Apelit nuk ka të drejtë që ta

anulojë aktgjykimin vetëm për shkak se do të preferonte shqiptimin e një dënimi më të butë apo më të ashpër. Gjykata e Apelit duhet ta pranojë dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë kur llogaritja e dënimit bëhet brenda intervalit të përcaktuar me ligj. Unë konstatoj se llogaritja e dënimit është ligjore dhe brenda intervalit të përcaktuar ligjor. Për këtë arsye, nuk ka hapësirë për ta anuluar aktgjykimin në fjalë.

Vërejtjet përfundimtare

Kolegji pretendon se nuk është e qartë nëse gjykata duhet të shqyrtojë ndonjë lëndë penale, civile apo administrative, pra lëndë të ligjit publik. Unë fuqishëm nuk pajtohem me këtë. Po qe se ka aktakuzë të mirëfilltë me akuza penale, atëherë prokurori e ka marrë përsipër lëndën penale. Gjykata është e detyruar me këtë vlerësim dhe i duhet të vendosë vetëm nëse i pandehuri e ka kryer apo nuk e ka kryer veprën penale në fjalë. Gjykata nuk ka të drejtë të diskutojë nëse lënda në fjalë duhet t'i caktohet gjykatës civile, gjykatës penale apo gjykatës administrative dhe duhet t'i përmbahet çështjes nëse kemi të bëjmë me vepër penale apo jo. Në fund, Gjykata e Apelit tashmë e ka theksuar kur ka vendosur mbi aktakuzën se e konsideron rëndësinë penale të lëndës në fjalë. Tash është shumë shqetësuese se kolegji ka mendime të tjera rreth rëndësisë penale të çështjes në fjalë duke e marrë këtë si justifikim për anulimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Unë pajtohem me kolegjin dhe pajtohem se aktgjykimi i kontestuar ka disa boshllëqe konkrete juridike, të cilat e shkelin nenin 370 të KPP-së. Megjithëkëtë, dua ta shpreh mendimin se nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për ta anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe për ta kthyer çështjen në rigjykim.

Kryetari i kolegjit

Piotr Bojarczuk
Gjyqtar i EULEX-it

--

Procesmbajtës

Dr. Bernd Franke
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit
Prishtinë

PAKR 349/14
31 gusht 2015